Poashtu me ndërtimin e këtyre hapësirave, paralelisht është paraparë që të bëhet edhe edukimi kohë shkurtër i kuadrit i cili do të bëjë fillimisht transplantimin autolog të palcës kockore, e pas 4-5 viteve tjera nëse plani shkon sipas dinamikës së paraparë, me një edukim shtesë të kuadrit multidisiplinar, mund të planifikohet edhe transplantimi alogjenik i palcës kockore dhe me këto mënyra të trajtimit do të kompletohet trajtimi i të sëmurëve hematoonkologjike, kështu që edhe në të jemi në hap me vendet e rajonit në trajtimin e avancuar të këtyre patologjive.

Këto planifikime për trajtimin e avancuar të këtyre patologjive do të lehtësohen duke pasur parasysh një numër të konsiderueshëm të specializantëve që kemi, e që aktualisht në specializim janë 17 specializantë, ku disa prej tyre deri ka fundi i vitit veç mbarojnë edukimet specialistike.

Korrespondenca:

shemsedin.sadiku@uni-pr.edu

ONKOLOGJIA PEDIATRIKE



Revista Mjeku

Artikull nga
Dr.Edea Blyta

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë çdo vit diagnostikohen 300.000 raste të reja me kancer te personat e moshës 0-19 vjeç.

Në Kosovë përkundër pengesave të shumta që e pengojnë aksesin për kujdesin e kancerit të fëmijët në sistemin shëndetësor, në repartin e hemato-onkologjisë pediatrike bëhet një punë heroike, me plot profesionalizëm, zell dhe përkushtim që fëmijët e prekur me kancer të shërohen.

Reparti i hemato-onkologjisë pediatrike ka filluar trajtimin induktiv të rasteve onkologjike në vitin 2008. Rasti i parë ka qenë trajtimi i një fëmije me Limfoma Hodgkin. Para kësaj periudhe trajtimi i rasteve onkologjike ka qenë në formë të terapisë mbajtëse. Në periudhën 1999-2009, Klinika e Hemato-Onkologjisë Pediatrike është udhëhequr nga Dr.Nazim Ymeri. Nga viti 2009 kjo klinikë udhëhiqet nga Ass.Dr.Violeta Grajqevci-Uka. Aktualisht, në repartin e hemato-onkologjisë në pediatri punojnë: Ass. Dr.Violeta Grajqevci – Uka, Dr.Bardhyl Abrashi, Dr.Rufadije Maçastena – Maxhuni, Dr.Florë Selimi, Dr.Enver Hasi, Dr.Arbana Baloku-Zejnullahu dhe Dr.Albana Xani.

“Gjatë kujdestarisë kemi pasur raste me komplikime shumë të mëdha dhe në bashkëpunim me anesteziologët kemi arritur që pacienti në mëngjes të jetë në gjendje stabile. Shërimi i fëmijës është gëzim i pabarrueshëm”. – Dr.Florë Selimi

Reparti ka 19 shtretër dhe kapacitete kadrovike të kënaqshme. Ka hapësirë laboratorike ku gjendet aparati për hemogram, mikroskopë, instrumenti për Flow Citometri, Cytospin, aparati për matjen e metotrexatit në serum etj.

Shefja e repartit Ass.Dr.Sc. Violeta Grajqevci – Uka thotë se “këto kapacitete të plotësojnë nevojat tona për fillimin e trajtimit në fazën e induksionit me kimioterapi”.

Në Kosovë mjekët pediatër ballafaqohen me të gjitha llojet e tumoreve të moshës pediatrike.

Përafërsisht 45-50% janë me leukemi.

Dr.Violeta Grajqevci – Uka tregon se tumoret të cilët trajtohen në repart janë: disa prej leukemive akute limfoblastike, disa prej tumoreve solide, limfomat e ndryshme, disa prej tumoreve gjerminativë, të sistemit nervor dhe rabdoid. Në anën tjetër nuk mund të trajtohen leukemite akute limfoblastike me bazë gjenetike pozitive (të cilat dërgohen jashtë vendit për transplant), leukemite akute mileoide, relapset si dhe të gjithë tumoret që kanë nevojë për kimioterapi + radioterapi ose vetëm radioterapi.

Reparti i hemato-onkologjisë posedon barnat për trajtim ku përveç barnatores qendrore të QKUK-së që siguron një sasi të citostatikëve, fatbardhësisht bashkëpunimi i ngushtë me shoqatat humanitare

luajnë një rol shumë të rëndësishëm në sigurimin e këtyre barnave dhe materialit harxhues.

Shoqatat “Care for Kosovo Kids” nga Holanda, “Cure 2 Children” nga Italia me seli në Prishtinë dhe “Ndihmë Fëmijëve me Kancer” nga Kosova, japin një kontribut të madh në zhvillimin e Onkologjisë Pediatrike duke përmbytur kështu misionin për trajtimin e fëmijëve me sëmundje malinje.

Prej vitit 2008 vazhdon bashkëpunimi me Shoqatën “Cure 2 Children” që ka bërë trajnimin e stafit.

“Shpresoj dhe uroj shumë që këtyre fëmijëve të ju sigurobet një mbështetje e madhe nga institucionet shtetërore”. – Dr.Violeta Grajqevci - Uka

Bashkëpunimi ndërkombëtar me Universitetet Evropiane, solli memorandumin e nënshkruar në vitin 2012 nga Klinika Universitare e Graz Austria si dhe një tjetër memorandum bashkëpunimi 5 vjeçar nga Spitali “Princess Maxima Center” nga Holanda. Këto veçe dëshmojnë punën intensive të mjekëve në Pediatrinë Onkologjike që është thelbësore për diagnostikimin dhe trajtimin e saktë.

Dr.Bardhyl Abrashi tregon se përkundër sfidave të stafit shëndetësor dhe ambientit që po renovohet që tre herë aty shpëtohen jetë falë fondacioneve ndërkombëtare dhe bashkë me mjekët tjerë bëjnë thirrje që të jenë prioritet në Ministrinë e Shëndetësisë, për shkak të ndjeshmërisë të natyrës së sëmundjeve që trajtohen. Poashtu, ndjehen të lumtur e optimistë që së shpejti do të zhvendosen në Spitalin e Ri Pediatrik i cili është duke u finalizuar.

Duke marrë parasysh specifikat e sëmundjeve që diagnostikohen dhe trajtohen, nevojitet një bashkëpunim i ngushtë jo vetëm midis mjekut, fëmijës dhe prindit por edhe psikologes së repartit që është domosdoshmëri sidomos atëherë kur informohen prindërit për sëmundjen e fëmijës së tyre, dhe koha e gjatë në repart bën që brenda mureve të këtij reparti të ndihen si një familje e madhe.

Dr.Florë Selimi shprehet se “komunikimi me prind është i shkëlqyeshëm, ne funksionojmë si një familje”, dhe shton nevojën e madhe të një protokoll që është marrëveshje midis prindit dhe mjekut.

Diagnoza e kancerit kur i kumtohet pacientit është zakonisht një kombinim i dëshpërimit, frikës dhe zemërimit. Se si mjeku jep lajmet në lidhje me diagnozën, për situatën e pacientit kanë një efekt të thellë në mirëqenien emocionale të pacientit. Mjekët e repartit hemato-onkologjik tregojnë se informimi i prindërve dhe pacientëve kur janë më të rritur, bëhet me një kujdes të shtuar dhe ju tregojnë çdo gjë për sëmundjen dhe të vërtetën sepse ata lexojnë dhe informohen edhe jashtë spitalit dhe kështu besimi ndaj mjekut do të jetë më i madh. Ndërkaq, tek fëmijët më të vegjël Dr.Violeta Grajqevci – Uka shton se ekzistojnë disa broshura me figura, që pak a

shume ju tregojmë për sëmundjen e tyre.

Ndërsa, numri i fëmijëve që referohen për jashtë vendit është i vogël dhe është i rezervuar vetëm për fëmijët me indikacione mjekësore që nuk kanë mundësi të trajtohen në Kosovë. Kostoja e trajtimit dallon prej sëmundjes si dhe nga spitali se ku trajtohet pacienti dhe procesi i rimbursimit për moshat pediatrike nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë është 100%.

Për trajtimin e një pacienti më sëmundje malinje, mjekët pediatër në onkologji shprehen se është një sfidë mjaftë e madhe dhe e kushtueshme si në aspektin profesional ashtu edhe në atë emocional.

e vështirë. Pastaj, vazhduam në repartin e ri që ka qenë donacion nga Shoqata “Nënë Tereza” nga Gjermania dhe gradualisht u përmirësuan kushtet dhe i përsosëm edhe protokollet duke rritur kështu gamën e veprimit dhe trajtimit.”

“Dalja e Revistës “Mjeku” është një hap shumë i rëndësishëm që e ka bërë Oda e Mjekëve të Kosovës në bashkëpunim me stafin mjekësor-akademikë. Revista “Mjeku” është një dritare ku të gjithë ne personeli shëndetësor mund ta paraqesim punën tonë të përditshme, sfidat dhe sukseset e trajtimit të pacientëve”. – Dr.Rufadije Maçastena – Maxhuni



“Do të veçoja dy pacientë; njëri e humbi betejën me sëmundje malinje dhe njëkohësisht erdhi tjetri që ia shpëtuan jetën. Sëmundjet malinje kanë sukseset dhe humbjet e veta”. – Dr.Violeta Grajevci – Uka

Dr.Rufadije Maçastena – Maxhuni kujton sfidat e viteve të para të repartit: “Kemi filluar punën me dy dhoma, me vetiniciativë të 3-4 mjekëve që kemi qenë në atë kohë, dhe pas edukimit të stafit shëndetësor kemi filluar me trajtimin e rasteve të para. Ka qenë një punë shumë sfiduese sepse në njërin anë kushtet teknike jo shumë të mira dhe në anën tjetër terapia shumë e kushtueshme për trajtim. Ka qenë shumë

Mjekët pediatër në repartin e hemato-onkologjise në Kosovë janë dëshmitarë jo vetëm të momenteve të dhimbshme të jetës por edhe të çasteve që i përmbushin në jetë vet këta mjekë. Puna dhe sakrificat e tyre e pandalshme drejt plotësimit të kushteve të repartit dhe avancimit në trajtim, kanë dhënë mundësinë e jetës aty ku vetëm disa vjet më parë nuk kishte shpresë. Këta mjekë japin maksimumin e tyre që të trajtohen dhe shërohen fëmijët që nesër mund të jenë liderë të mëdhenj për këtë vend.

Të jesh pediatër onkolog nuk është thjeshtë një punë, është mision dhe thirrje në të njëjtën kohë.

DIAGNOSTIKIMI I TUMOREVE NË INSTITUT TË ANATOMISË PATOLOGJIKE QENDRA KLINIKE UNIVERSITARE E KOSOVËS



Rinë Limani

*Drejtoreshë e Instituteve
Paraklinike*

*Specialiste e Patologjisë
Instituti i Patologjisë
SHSKUK - FM*

Për diagnostikimin e tumoreve në të shumtën e rasteve patologët e kanë fjalën e fundit. Pavarësisht nga dyshimet klinike, diagnostikimi i tumoreve nuk mund të bëhet në mungesë të ekzaminimit histopatologjik dhe/ose atij citologjik. Për më shumë, me përjashtime të rralla, trajtimi i tumoreve malinje nuk guxon të fillohet në mungesë të diagnostikimit histopatologjik apo citologjik.

Jo shumë kohë më parë, ka mjaftuar ndarja e tumoreve në beninj dhe kancere për t'i ofruar klinikistit të gjitha informatat e duhura për kujdes adekuat ndaj pacientit. Përderisa, sot tumoret, e në veçanti kanceret, nuk janë më vetëm një sëmundje. Secili tumor i ka karakteristikat e veta të sjelljes biologjike dhe të zhvillimit. Zhvillimet e jashtëzakonshme në fushën e onkologjisë e kanë bërë të domosdoshme ofrimin e informatave shtesë për të mundësuar klasifikimin e duhur të tumoreve, dhe për të përcaktuar prognozën dhe intervenimin terapeutik të tumoret. Të dhënat për tipin dhe origjinën e tumorit, diferencimin e tij, invazionin, numrin e nyjeve limfatike me dhe pa tumor metastatik, ploeditetin, numrin e mitozave, praninë ose jo të receptorëve hormonal, ekspresionin e proteinave dhe aktivitetin e enzimave specifike, të gjitha janë bërë pjesë e raporteve standarde rutinore histopatologjike (1).



Patologët merren në radhë të parë me ekzaminimin e strukturës së qelizës, indit dhe organit.

Ekzaminimet citologjike aplikohen me qëllime diagnostike dhe për skringing të lezioneve prekanceroze dhe kancereve. Ekzaminimi i materialeve citologjike të marra me aspirim me gjilpërë të hollë (Fine needle aspiration- FNA), marrja me brushë e materialeve, ekzaminimi citologjik i qelizave eksfoliative në lëngje trupore si urinë, sputum, lëng cerebrospinal, lëng pleural, lëng perikardial dhe ascit aplikohen për përcaktim të diagnozës të tumoret. Në materiale citologjike sot mund të aplikohen edhe ngjyrimet dhe metoda tjera ndihmëse diagnostike për të ofruar të dhëna më specifike për diagnozën (1).

Në ekzaminim histopatologjik të biopsive, ekzaminimi i kujdesshëm makroskopik, përcillet me ekzaminim më të detajuar të prerjeve indore me

mikroskop optik.

Patologët duhet të jenë të informuar për të dhënat klinike, përfshirë diagnozat diferenciale klinike, rezultatet laboratorike e imazherike, dukjen makroskopike të indit, të dhënat nëse ka pas ekzaminime të mëparshme dhe diagnozat e mëparshme histopatologjike e citologjike.

Për më shumë, materialet e dërguara për ekzaminim histopatologjik duhet të markohen me kapëse, penj ose ngjyrë për të ndihmuar në orientimin anatomik.

Standard në histopatologji është ekzaminimi në mikroskop optik i prerjeve të indeve të fiksuara në formalinë neutrale të pufizuar 10%, të zhytura në parafinë dhe të ngjyrosura me hematoksilinë dhe eozinë (H & E). Procedurë kjo e cila e mundëson që struktura e qelizës dhe ajo e indit të ruhet mire (1).

Metodat ndihmëse diagnostikuese si histokimia, imunohistokimia me ose pa fluoreshencë, metodat e ndryshme të in situ hibridizimit, mikroskopia elektronike, biologjia molekulare me PCR (polymerase chain reaction) dhe NGS (next gene sequencing) ndihmojnë në diagnostikim të tumoreve si dhe japin infomata shtesë prognostike dhe terapeutike për pacientin.

Histokimia si metodë ndihmëse për diagnostikim në patologji ka filluar të aplikohet në fund të shekullit 19 (2). Ngjyrimet histokimike aplikohen për identifikimin e qelizave dhe strukturave përbërëse të indeve, për identifikimin e mikroorganizmave të ndryshëm si dhe për identifikimin e depozitimeve të elementeve dhe substancave të ndryshme në qeliza dhe inde. Në Institutin e Anatomisë Patologjike në QKUK sot në rutinë të ekzaminimeve histopatologjike të biopsive të marra nga lukthi përveç ngjyrimet me H & E e aplikojmë edhe ngjyrimin me May-Grunwald Giemsa, për të ndihmuar në identifikimin më të lehtë të mikroorganizmit *Helicobacter Pylori*. Standard i artë për diagnostikim të infeksionit me *Helicobacter Pylori* në lukth, është diagnostikimi i ndryshimeve morfologjike dhe identifikimi i *Helicobacter Pylori* në biopsi (3).

Në Institut të Anatomisë Patologjike në Qendrëmbn

Klinke Universitare, QKUK aplikohen edhe ngjyrimet histokimike si Silver Reticulina, Alcian blue, Prussian blue, Periodic acid-Schiff (PAS), Masson's trichrome, Congo Red dhe Ziehl-Neelsen, si ngjyrimet standarde të domosdoshme për diagnostikim citologjik dhe histopatologjik.

Imunohistokimia (IHC) është metodë e ngjyrimet e cila i identifikon antigenet specifik në qeliza dhe inde të fiksuara në formalinë dhe të zhytura në parafinë përmes antitropave specifik për antigjene (4). Antitropa mono dhe poliklonale të markuar me enizma (imunoperoksidaza) ose me fluorofore (imunofluoreshencë) aplikohen për të identifikuar proteinat dhe molekulat tjera në qeliza të indeve të shëndosha dhe të proceset e ndryshme patologjike. Ngjyrimet IHC aplikohen për qëllime diagnostike, prognostike dhe terapeutike (4).

Në Institut të Anatomisë Patologjike, QKUK nga viti 2005 aplikohet ngjyrimi IHC me imunoperoksidazë. Nga viti 2020 me aktivizimin e Aparatit për ngjyrim imunohistokimik Autostainer Link 48, dhe me sigurimin e Aparatit për ngjyrosje automatike Ventana GX Benchmark, ngjyrimet imunohistokimike kryhen në numrin më të madhe në mënyrë automatike.

Kalimi nga ngjyrimi manual në atë automatik, ka mundësuar që kualiteti i ngjyrimëve të jetë konform standardeve ndërkombëtare, ka eliminuar dukshëm gabimet teknike të varura nga faktori njeri, e për më shumë me rritjen e kapacitetit të ngjyrimet është shkurtuar koha e pritjes për ngjyrimet.

Në Institutin e Anatomisë Patologjike, QKUK përveç markerëve të IHC të cilat aplikohen për qëllime diagnostike, bëhen edhe markerë me rëndësi prognostike dhe terapeutike si receptorët për estrogen dhe progesteron dhe produktet e proteinave të onkogjeneve si HER-2/neu të kancerit i gjirit, si dhe antigenet të cilat tregojnë për indeksin e proliferimit të qelizave tumorale si Ki-67.

Nga viti 2020 me kërkesë të onkologëve kemi filluar edhe me testimin për biomarkerët si PD-L1 (SP124) me rëndësi terapeutike për kancerin e gjirit në rastet kur receptorët hormonal dhe HER-2/neu janë negative si dhe PD-L1 (SP 263) dhe ALK (D5F3) me rëndësi terapeutike për kanceret e avancuara me qeliza jo të vogla të mushkërive.

Për më shumë, me sigurimin e mikroskopit fluoreshentë në gjysmën e dytë të vitit 2021 planifikojmë të fillojmë edhe me ngjyrimet IHC fluorofore (imunofluoreshenca) me rëndësi të veçantë diagnostike për patologji të veshkave dhe të lëkurës.

Këtë vit, për herë të parë në Kosovë me sigurimin e aparatit Ventana GX- Benchmark kemi filluar edhe të punojmë metodën e Silver In Situ Hibridizimit të kanceret e gjirit të cilat rezultati i HER-2/neu me ekzaminim IHC është i papërcaktuar (HER-2/neu 2+). Kjo metodë punohet me VENTANA HER2 Dual ISH DNA Probe Cocktail dhe e përcakton statusin e amplifikimit të HER2 gjenit duke numëruar raportin ndërmjet gjenit HER2 me Kromozomin 17 në mikroskop optik (5).

Me zhvillimet e fundit në fushën e onkologjisë kemi aplikim të gjerë në patologji të metodave molekulare

si PCR dhe NGS, të cilat janë me rëndësi diagnostike, prognostike e terapeutike.

Metodat e ndryshme të PCR me amplifikim të ADN-së (acidit dezoksiribonukleik) përdoren për detektim të mutacioneve të gjeneve apo translokacioneve të tumorit dhe ndihmojnë në përcaktimin e diagnozës dhe ofrojnë të dhëna për trajtimin terapeutik të tumoreve (6).

NGS është teknologjia e fundit me të cilën përcaktohen sekuencat e ADN-së dhe ARN-së (acidit ribonukleik) për të studiuar variacionet gjenetike të ndërlidhura me patologji të ndryshme dhe tiparet tjera biologjike. NGS për herë të parë është prezantuar për përdorim komercial në vitin 2005, dhe në fillim është quajtur "sekuencim masiv paralel", pasi që ka mundësuar të sekuencohen disa zinxhirë të ADN-së në të njëjtën kohë, për dallim nga PCR metoda me të cilën mund të sekuencohet vetëm një zinxhirë i ADN-së për test. Rekomandimet e Shoqatës Evropiane për Onkologji Mjekësore (ESMO) janë që NGS si metodë testuese të aplikohet në mënyrë rutinore në mostra të tumoreve të kanceret e avancuara me qeliza jo të vogla të mushkërive, të kancerit i avancuar i prostatës, kanceri i avancuar i ovarëve dhe të kolangiokarcinomat. Sipas ESMO rekomandimeve NGS mund të jetë alternativë e PCR testimeve për kancerin e kollonit, si dhe rekomandohet për përcaktimin e ngarkesës me mutacione tumorale (tumor mutational burden) të anti-programmed cell death PD-1 për të përcaktuar përgjigjen në imunoterapi të pacientët me kancer të endometrit, kancer të mushkërive me qeliza të vogla, të tumoret nuroendokrine mirë dhe mesatarisht të diferencuara, të kancerit i gjëndrave salivare, kanceri i tiroidës dhe kanceri i vulvës (7).

NGS si metodë është mjaft komplekse dhe FDA (Food and Drug Administration, Shtetet e Bashkuara të Amerikës) ka aprovuar deri më sot një numër të vogël të testeve të cilat i kanë plotësuar kriteret për testim të besueshëm. Të aprovuara nga FDA janë: Focus CDxBRCA Assay (Foundation Medicine); FoundationOne CDx (Foundation Medicine); Myriad myChoice CDx (Myriad Genetic Laboratories); Guardant360 CDx (Guardant Health) dhe FoundationOne Liquid CDx (Foundation Medicine) (8-10).

FoundationOne CDx (F1CDx) është testim diagnostik in vitro përmes së cilës detektohen zëvendësimet, alterimet me insertim dhe delecionet (indels), alterimet e numrit të kopjeve (CNAs) në 324 gjene, riarranzhimet në gjene të selektuara, si dhe jostabiliteti mikrosatelitor (MSI) dhe ngarkesa me mutacion të tumorit (TMB) në ADN të izoluar nga indi tumoral i fiksuar në formalinë dhe i zhytur në parafinë (10).

Instituti i Anatomisë Patologjike në QKUK, është në proces të planifikimit për gjetjen e moduleve të përballeshme ekonomikisht dhe të dobishme për pacientët për testim me PCR dhe NGS.

Praktika klinike është duke shkuar drejt një epoke ku të dhënat molekulare do të mundësojnë që trajtimi i tumoreve të jetë i personalizuar sipas profilit genomik unik të tumorit të pacientit. Roli i patologut në këtë proces është kyç si për diagnostikim të tumoreve ashtu edhe në vendimarrje të trajtimit terapeutik..

Literatura:

1. Connolly JL, Schnitt SJ, Wang HH, et al. Role of the Surgical Pathologist in the Diagnosis and Management of the Cancer Patient. In: Kufe DW, Pollock RE, Weichselbaum RR, et al., editors. *Holland-Frei Cancer Medicine. 6th edition.* Hamilton (ON): BC Decker; 2003.
2. Riva MA, Manzoni M, Isimbaldi G, Cesana G, Pagni F. *Histochemistry: historical development and current use in pathology.* *Biotech Histochem.* 2014 Feb;89(2):81-90.
3. Sabbagh, P., Mohammadnia-Afrouzi, M., Javanian, M. et al. *Diagnostic methods for Helicobacter pylori infection: ideals, options, and limitations.* *Eur J Clin Microbiol Infect Dis* 38, 55–66 (2019).
4. McKenney, Jesse K. MD*, Hornick, Jason L. MD, PhD† *Immunohistochemistry in Surgical Pathology, Advances In Anatomic Pathology: November 2018 - Volume 25 - Issue 6 - p 373.*
5. *Human Epidermal Growth Factor Receptor 2 Testing in Breast Cancer: American Society of Clinical Oncology/ College of American Pathologists Clinical Practice Guideline Focused Update Antonio C. Wolff, M. Elizabeth Hale Hammond, Kimberly H. Allison, Brittany E. Harvey, Pamela B. Mangu, John M.S. Bartlett, Michael Bilous, Ian O. Ellis, Patrick Fitzgibbons, Wedad Hanna, Robert B. Jenkins, Michael F. Press, Patricia A. Spears, Gail H. Vance, Giuseppe Viale, Lisa M. McShane, and Mitchell Dowsett. Journal of Clinical Oncology 2018 36:20, 2105-2122.*
6. Evans MF. *The polymerase chain reaction and pathology practice.* *Diagn Histopathol (Oxf).* 2009;15(7):344-356.
7. Mosele F, Remon J, Mateo J, et al. *Recommendations for the use of next-generation sequencing (NGS) for patients with metastatic cancers: A report from the ESMO Precision Medicine Working Group.* *Ann Oncol.* 2020.
8. Rozenblum, AB., et al. (2017) *J Thorac Oncol* 12:258-68; 2. Schwaederle, M., Kurzrock, R. (2015) *Oncoscience* 2:779-80.
9. Mansinbo, A., et al. (2017) *Expert Rev Anticancer Ther* 17:563-65;
10. *FoundationOne CDx FDA Approval (2017) Available at: https://www.accessdata.fda.gov/cdrb_docs/pdf/17/P170019a.pdf.*

BORDI NACIONAL PËR KONTROLL TË KANCERIT

Ju jeni Kryetarja e re e Bordit Nacional për Kontroll të Kancerit (BNKK). Ju lutem na tregoni diçka për Programin Nacional për Kontroll të Kancerit në Kosovë (PNKK)?

Unë jam Kryesuesja e Bordit për Zhvillimin e Programit Shtetëror për Kontrollin e Kancerit, e emëruar në nëntor të vitit 2020. Meqë emërimi në këtë pozitë erdhi në një kohë të pakohë në pandemi, aktivitetet kanë qenë të pamundura dhe të cinguar për shkaqe pandemie. Kjo nuk ka ndodh vetëm tek ne, por për fat të keq në tërë botën. Fokusi ka qenë pandemia dhe mundësia për të luftuar Covid 19 dhe vëmendja në sëmundjet tjera përfshirë këtu edhe kancerin ka qenë e zbehur. Në vendet e zhvilluara në Evropë, ku kanë strategji të mirëfillta për parandalimin, zbulimin e hershëm, diagnostikimin dhe trajtimin e mirëfillt të sëmundjeve kanceroze, hendeku që ka shkaktuar pandemia ka qenë dhe vazhdon të jetë i madh. Këtu nuk bënë përjashtim as Kosova. Një hulumtim i fundit tregoi që gjatë pandemisë, rreth një milion raste me kancer mund të jenë të padiagnostikuara në Evropë, rreth 100 milion teste për skreningun e kancerit nuk janë kryer (që do të ndikoj në të ardhmen në diagnostikim të rasteve të reja në stadi të avancuara dhe në rënie të mbijetesës së përgjithshme), 1 në 2 njerëz me simptome potenciale për kancer nuk janë referuar urgjentisht për diagnostikim si dhe 1 në 5 paciente me kancer në Evropë aktualisht akoma nuk kanë marrë trajtimin e nevojshëm kirurgjik ose me kimioterapi. Pasojat e tilla nga pandemia zgjuan edhe Bashkimin Evropian, zyrën për shëndetësi të lansojnë kampanjën me 11 maj “Koha për Veprim” – “Time to Act”, ku me materiale të ndryshme të nxisin çdo vend në Evropë që të restaurojnë sa më shpejtë shërbimet e kancerit për t’i ikur mundësisë që pandemia Covid 19 të shkaktojë një epidemi të re të kancerit. Ftoj organet e larta të shëndetësisë në Kosovë, zyrën e Bashkimit Evropian, organizatat tjera ndërkombëtare shëndetësore në Kosovë që të na bëjnë pjesë përbërëse të kampanjave të tilla ku mund të përfitoj edhe Kosova. Meqë zyrat ndërlidhëse janë në Kosovë për të ndihmuar popullin e Kosovës, mendoj që lufta kundër kancerit është luftë e përbashkët, veçanërisht kur dihet se vdekjet nga kanceri janë shkaktaret kryesor të vdekjeve në mbar botën. Covid-19 na tregoi se ekzistojnë dallime të mëdha në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në mes të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim, nxori në pah edhe në fillim egoizmin, ku secili vend luftonte për vete, por më vonë, me njohjen e virusit filloi edhe solidariteti. Një dallim i tilla ekziston edhe në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për sëmundjet kanceroze në mes të vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim. Meqë bëhet fjalë për sëmundje kronike - kancerin, dallimet e tilla nuk vihen në pah menjëherë, por ato ekzistojnë dhe hendeku është në rritje e sipër. Për kancerin është folur qysh moti, 3000 vite para erës sonë, andaj besoj se ka vend vetëm për solidaritet dhe më shumë bashkëpunim në mes të vendeve në zhvillim dhe vendeve të zhvilluara.

Sa është mbështetur ky program nga Ministria e Shëndetësisë si Institucion implementues i këtij programi?

Ministria e Shëndetësisë, besoj se me kthimin në normalitet nga pandemia, do të vazhdoj mbështetjen si dhe dakordimin në lidhje me prioritetet për kontrollin e kancerit në vendin tonë, në bashkëpunim me të gjithë profesionistët e fushës. Mbase edhe duhet përsëritur që lufta kundër kancerit është luftë e përbashkët e të gjithëve, idetë e secilit do të mund të kontribuonin qoftë në parandalim, detektim të hershëm, diagnostikim, trajtim, kujdes paliativ, me te vetmin qëllim që pacientet tonë të jetojnë më gjatë dhe të kenë një jetë kualitative deri në fund.

A mendoni se program ekzistues duhet plotësuar apo ndryshuar?

Puna e bërë në hartimin e programit ekzistues është për t’u vlerësuar. Aty kanë punuar profesionistë të fushës, të cilët kanë njohur mirë problematiken e sëmundjeve kanceroze në vendin tonë. Është më së normale që programet e tilla me kohën duhet plotësuar dhe përshtatur edhe rrethanave kohore.

Sipas jush, cilët mund të jenë faktorët që vështirësojnë implementimin e masave të parapara me PNKK

Implementimi i programeve të skreningut me qëllim të detektimit të hershëm, pastaj teknikat e reja diagnostike molekulare, procedurat e ndryshme kirurgjike, barërat e reja onkologjike specifike, kanë kosto. Megjithatë, gjithmonë duhet shikuar mundësia e implementimit të programeve duke ju përshtatur rrethanave ekzistuese, në mënyrë që të gjejmë modalitete të përafërta që kanë funksionuar në vende të tjera në zhvillim. Harmonizimi i shërbimeve aktuale, multidiciplinariteti, bashkëpunimi në mes të profesionistëve shëndetësor, bordet tumorale, konsiliumet mjekësore, të gjitha këto rrisin cilësinë e ofrimit të shërbimeve për pacientet me kancer. Ne boten e zhvilluar kjo i takon se shkuarës, ndersa ne duhet te vrapojme për te arritur qëllimet e përbashkëta. Fakti se Kosova ka moshën mesatare të popullatës të re 30.2 vjeç, nuk duhet të na relaksojë. Përkundrazi, koha është në favorin tonë për hartim të programeve gjithëpërfshirëse për parandalim, detektim të hershëm, diagnostikim dhe trajtim, meqë popullata jonë pritet që në vitin 2061 të arrijë moshën mesatare ne 45 vjeç.

Cili është aktualiteti në lidhje me Regjistrin e Kancerit në Kosovë

Kjo pyetje do duhej t’i adresohet institucionit përgjegjës e që është Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik në Kosovë. Megjithatë, mendoj që ka përmirësim në raportimin e sëmundjeve malinje viteve të fundit. Kancer regjistri është shumë i rëndësishëm. Të dhënat për incidencen, mortalitetin por edhe për shërbimet kanceroze janë më së të rëndësishme. Këto të dhëna janë të rëndësishme për të kuptuar shtrirjen e kancerit. Përmes një kancer regjistri të mirëfillt do të mund të përcilleshin ndryshimet në incidence dhe mortalitet, e me këtë edhe hartimin e programeve preventive si dhe atyre për trajtim.

Korrespondenca:

dafinaademi@hotmail.com

ORGANIZIMI I ONKOLOGJISË NË BRITANI TË MADHE



Ernesë Gjafa

*Specialiste Onkologe
St Bartholomew's Hospital,
Department of
Medical Oncology, London*

Një ndër lëmitë më sfiduese në mjekësi për mua mbetet Onkologjia. Ndoshta edhe kjo ka qenë arsyeja pse jam orientuar drejt saj. Zhvillimet e reja dhe të arriturat gjatë dekadave të fundit, por madje edhe çdo 5 vite, janë aq të mëdha sa që edhe ne si profesionistë jemi të vetëdijshëm që praktika jonë evolon aq shumë sa që ndërrimet dhe adaptimet në menaxhimin e kancerit janë të pashmangshme.

Këto ndërrime rapide janë bërë të mundura falë studimeve të shumta klinike që bëhen në qendra të njohura universitare në botë, por gjithashtu edhe falë bashkëpunimit mes qendrave duke realizuar pjesëmarrje të qindra mijëra pacientëve, rezultatet e të cilave mundësojnë të ofrojnë mjekime të bazuara në evidencë klinike.

Studimet vazhdojnë si në laboratore me punë shkencore ashtu dhe në klinikat tona duke i rekrutuar këta pacientë për studime klinike dhe duke i përcjellur për së afërmi. Falë këtyre studimeve tani kemi imunoterapitë (PDL and PDL1 inhibitors, CTL4 inhibitors) që përdoren me sukses në kancer të mushkërive, të kokës e qafës, melanoma, kancer të zorrëve me mutacione në BRAF, TKI (inhibitorët e tirozin kinazës) që përdoren në kancer të mushkërive, veshkave, GIST, inhibitorët e PARP që e kanë revolucionarizuar tretmanin e kancerit të vezoreve e sidomos te femrat me mutacion në gjenin BRCA, e shumë tretmaneve tjera që kanë modifikuar menaxhimet e kancerit krahas regjimenteve pak më të vjetra si Kemoterapia/Radioterapia po që tani edhe kombinohen së bashku duke ofruar efikasitet më të lartë.

Të gjitha këto tretmane janë tejet interesante dhe informatat në lidhje me këto protokole janë në dispozicion nga Shoqëria Evropiane e Onkologëve Mjekësor (ESMO), Shoqëria Amerikane e Onkologëve Klinikë (ASCO), si dhe resurse të shumta në internet që mund të lexohen jo vetëm nga profesionistët por edhe pacientët.

Por këtu nuk qëndron dhe bazohet mënyra e edukimit të një onkologu duke marrë parasysh që jo të gjitha vendet e botës kanë mundësi t'i kenë këto tretmane, e jam e vetëdijshme që edhe Kosova bën pjesë në këtë grup. Kjo më shtyu se ndoshta është më e dobishme të shtjelloj se si është e organizuar onkologjia si specializim në një vend si Britania dhe si organizimet në kuadër të departamentit mundësojnë mjekimin e qindra pacientëve me kancere të ndryshme e që mund të shërbej si model për të ardhmen e Onkologjisë në vendin tonë.

Menaxhimi i pacientëve me kancer është kompleks dhe përfshin angazhim multimodal profesionistësh të ndryshëm duke filluar nga ne onkologët, kirurgu, histopatologu, radiologu, infermierët specialistë dhe farmacist. Vetëm me një bashkëpunim kolegial dhe të afërt shërbimet ndaj pacientëve tonë do të jenë superiore.

Edukimi pasuniversitar i një mjeku në Britani është pak sa ndryshe nga vendet tjera të Evropës. Fillohet me dy vite bazë FY1 dhe FY2 (të ashtuquajtura foundation) ku fitohet përvoja katër mujore në specializime të

ndryshme duke përfshirë këtu mjekësinë interne (Gastroenterologji, Kardiologji, Geriatri, Emergjencë, Mjekësi akute, etj.) dhe gjithashtu eksperiencë gjashtë mujore në kirurgji (Ortopedi, Kirurgji të përgjithshme, vaskulare). Pas këtyre dy viteve mjeku i ri orientohet në zgjedhje të mjekësisë interne apo kirurgji/pediatri/mjekësi familjare ose gjinekologji si lëmi klinike.

Në mënyrë që të merret subspecializimi në Onkologji rrugëtimi duhet të fillojë me mjekësinë interne (IMT -internal medical training) e cila zgjatë 2 deri në 3 vite. Gjatë këtyre 2-3 viteve çdo 4 muaj fitohet eksperiencia në lëmi të ndryshme të mjekësisë interne po edhe emergjencën dhe kujdesin intensiv, rotacione të caktuara nga Dekanati që fitohen me një kompeticion mjaft rigoroz për mjekët e rinj.

Gjatë këtyre 2-3 viteve duhet të përfundohen tri provime të mëdha që përfshinë gjithë mjekësinë MRCP 1+2 dhe PACES duke ia mundësuar mjekut t'i arrijë kompetencat e internistit dhe emërimin si pjesëtar i Kolegjit Mbretëror të Fizicientëve (RCP).

Ky provim dhe trajnim dëshmon se çdo mjek është kompetent t'i menaxhoj çoftë prezantimet akute po edhe kronike të pacientëve të ndryshëm e jo të fokusohet vetëm në subspecializimin e tyre. Pas kësaj pason konkurrimi për subspecializim në Onkologji që përfshin një kompeticion rigoroz duke marrë parasysh që numri vjetor në tërë Britaninë është diku 30-35 specializantë për Onkologji Mjekësore (Medical Oncology), për afërsisht i njëjtë edhe për Onkologji klinike (Clinical Oncology). Konkurrenca është jashtëzakonisht e madhe, një krahasim relevant do ishte që psh. në Londër jepen për afërsisht 10 numra specialistik në vit në Onkologji Mjekësore, e diku 450 numra në mjekësi familjare.



Fotografia 1. Spitali St Bartholomew's është spitali më i vjetër në Britani të Madhe që ka një histori të lashtë dhe daton nga shekulli i XII (1123). Ndërtesat e këtij spitali e kanë përballuar edhe flakën e madhe të Londrës ku qendra është shkatërruar plotësisht në vitin 1666 e edhe bombardimet nga Lufta e Dytë botërore

Këto specializime janë të ndara vetëm në Britaninë e Madhe. Onkologjia Klinike në një vend tjetër do të quhej Onkologjia e Rrezatimit, por tek ne përpos rrezatimit mjekët mund të ofrojnë edhe kemoterapi, imunoterapi dhe tretmane tjera. Është shumë e dobishme kur tretmani përfshin të dy ose tre modalitetet. Specializimi zgjatë 5 vite nëse nuk ndërpritet për shkak të përfundimit të PhD-së apo MD-së në mënyrë që t'i kushtohet kohë shkencës/

hulumtimit, dhe pas 2 provimeve (FRCR 1 dhe FRCR 2) në kuadër të specializimit mjeku bëhet pjesëtar i Kolegjit Mbretëror të Radiologëve (FRCR).

Specializimi në Onkologji Mjekësore zgjatë 4 vite gjithashtu me studime shkencore deri në 7-8 vite. E përfshinë provimin specialistik në përfundim të së cilit emërohet pjesëtar në RCP në Onkologji. Onkologjia Mjekësore merret me të gjitha modalitetet e tretmanëve pos me rrezatim. Bazë i ka studimet klinike dhe ato i drejton në të gjitha qendrat akademike.

Ky është pak a shumë rrugëtimi i një Onkologu në Britaninë e Madhe, që merr diku 10-15 vite punë pas diplomimit në Mjekësisë duke përfshirë studime, kompetenca, të arritura shkencore, publikime, etj., dhe kurorëzohet me titullin Konsulent (Consultant) si grada më e lartë e një mjeku duke përjashtuar titujt shkencorë.



Fotografia 2. Spitali St Bartholomew's është qendër specialiste terciare për Kardiologji dhe Onkologji. Është institucion akademik i lidhur me Queen Mary University. Rishtazi edhe Princi i ndjerë princ Philip është mjekuar këtu që e bëri që ky spital të shihet edhe më shumë në media

Onkologu sipas të lartpërmendurës është edhe internist dhe duhet ta menaxhoj pacientin edhe jashtë kornizave të kancerit dhe tretmanëve onkologjike. Kjo si tërësi është më adekuate për pacientin; tretmani që jepet është shumë më optimal në mënyrë që ata mos të kalojnë prej një mjeku në tjetrin për arsye shume të vogla, që rezultojnë çoftë nga vet kanceri apo tretmanet. Ne kemi bashkëpunim të ngushtë më të gjithë specialistët tjerë edhe kur gjërat janë më të komplikuar ata thirren në ndihmë, madje edhe shumë herët.

Onkologjia mbetet si specializim që punon në kuadër të ekipit multidisciplinar dhe kjo spjegohet nga vet fakti që çdo pacient i ri fillon rrugëtimin e tij pasi që është diskutuar në MDT (Takimi i Ekipit Multidisiplinar), bord që përfshinë onkologun (mjekësor dhe klinik), kirurgun, radiologun, histopatologun dhe infermierët specialistë.

Aty diskutohet plani përkatës dhe Onkologu e sheh pacientin vetëm atëherë mbasi i është konfirmuar diagnoza nga kirurgu apo mjeku që e ka referuar për biopsi (jo nga histopatologu, radiologu, infermieri, etj). Nuk ndodhë që ne të shohim pacientin i cili nuk di për diagnozën e tij, medoemos sqarime detajore jepen në prezencë të infermieres së specializuar.

Çdo onkolog mjekon 1-2 lloje të tumoreve, e rrallë herë të tretin. Grupet e mëdha të tumoreve përfshijnë: kancerin e gjirit, mushkërive, gastrointestinale të epërme (oesofagu, lukthi, melqia dhe pankreasi) dhe të poshtme (zorrët e holla dhe të trasha), dhe grupet më pak të mëdha si gjinekologjike, urologjike, kokë

/qafë si dhe ato më të rralla si tiroid, truri, NET, adrenal, tumoret embrionale (germ cell), sarkomat, etj. Kombinimet përfshijnë një grup të tumorit të madh dhe një më të rrallë.

Është e pamundur ta ndjekësh hapin e të arriturave shkencore në Onkologji nëse zgjerohesh të mjekosh më shumë se dy lloje të tumoreve. Me këtë bëhet e çartë edhe për kolegë, pacientë, infermierë, farmacistë e opinionin e gjerë se kush mjekon cilin tumor dhe te gjithë kanë mundësi të shkëlqejnë në ekipin e tyre.



Emra të mëdhenj në mjekësi janë pjesë të historisë së këtij spitali siç është Zt Percival Pott (1714- 1788) kirurg që njihet si babai i Ortopedisë, Zt James Paget (1814 –1899) kirurg e patolog që ka emëruar sëmundjen Paget (Paget's disease) e të panumërt të tjerë që me krenari tregojnë që janë pjesë e këtij institucioni akademik.

Edhe unë mbetem njëra nga ata që kam pas fatin të përfundoj specializimin në Onkologji në kuadër të spitalit St Bartholomew.

Një qendër specialiste përfshin repartin për pacientët që kanë nevojë për hospitalizim çoftë për shkak të tretmanëve shumë ditëshe që duhen monitoruar për së afërmi, komplikime të tretmanëve apo të sëmundjes. Përfshinë repartin ditor ku jepen tretmanet dhe mbikëqyret nga mjeku i ditës, shumë infermierë dhe farmacistë. Klinikat e organizuara tri herë në javë për tumore të caktuara, AOS (Acute Oncology Service) që i përcjellë pacientët onkologjik që prezantojnë në spitale periferike dhe mjekët komunikojnë me ekipin amë, CAU (Clinical Admission Unit) që punon sipas orarit 8-20 ku shihen pacientët me komplikime akute si infeksionet, çrregullimet e elektroliteve, embolite, kompresione të boshitit spinal dhe të gjitha komplikimet të lidhura me kancer apo terapi. Ky departament mbikëqyret nga 2 mjekë specializantë (1 onkolog dhe një internist më i ri), si dhe së fundi shërbimi 24 orë për pacientë që udhëhiqet nga infermieri/a specialist (hotline) në telefon dhe është në dispozicion për gjithë pacientët. Ata mund të thërrasin dhe të konsultohen nëse kanë probleme për shkak të terapisë dhe pas komunikimit me mjekët vendoset ose të hospitalizohen apo këshillohen si t'i menaxhojnë shenjat dhe simptomat e tyre në shtëpi.

Kjo e përbënë një sistem të avansuar të menaxhimit të pacientëve në Onkologji dhe krijimit të një raporti të afërt me pacientë dhe bashkëpunim të ngushtë me kolegë.

Literatura:

1. Joint Royal Colleges of Physicians Training Board- Training pathway in Medical Oncology
2. <https://www.rcr.ac.uk/clinical-oncology> - Royal College of Radiologists- Training pathway in Clinical Oncology
3. Joint Royal Colleges of Physicians Training Board (Internal Medicine Training (IMT)

ZBULIMI I HERSHËM - MBIJETESË



Nafije Latifi

Shoqata Jeta Vita

Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit “JETA/VITA” është themeluar në vitin 2006, kur mungonte informata, ndërgjegjësimi, diagnostikimi dhe trajtimi, kur nuk kishite as onkologë të specializuar, as institucion onkologjik, prandaj kjo temë në popullatë ishte gati tabu.

Ideja për themelimin e kësaj Qendre u realizua rreth dy vite pas përballjes sime me këtë sëmundje dhe gjithë atyre problemeve për t’u diagnostikuar dhe trajtuar, gjithë atyre dilemave, çka të bëjë, ku të shkoj, te kush, a din, a mundet, a do t’ia dal...? Kur u këndella pak për vete, mendova...çka bëjnë të tjerat që nuk e kanë informatën, familjen time, mundësitë materiale, miqtë e mijë? Dëshiroja t’i takoja ato gra nëpër ordianca, ku duhej shkuar për kontrolla të vazhdueshme, të pijmë një kafe, të qajmë hallet tona.

Ndoshta do t’ju duket rrëfim paksa i personalizuar i një pacienteje, asokohe 54 vjeçe, gazetare në kulm të karrierës; që rrëfen shokun, vuajtjen, trajtimet në Gjermani, Shkup e Prishtinë, ditët e netët pa vullnet e përmbajtje, situata pa mundësi të llogaritjes së ditëve të ardhshme. Ky ishte realiteti im.

Nisma - përsëri ishte familja ime, miqtë, por edhe ekspertet mjekësore që e ndihmuan punën. Pasi kisha hulumtuar për përvojat që bëheshin nëpër botë, mendova se kjo ishte mënyra e duhur për ti dhënë zë. Filluam me protestë në Ditën e Gruas, 8 Mars, para hotelit Grand. Qindra gra që vinin për të festuar me lule në dorë, e ne, disa vullnetare me një pankartë të madhe 2 x 3 m, refuzonim lulet dhe kërkonim më shumë kujdes për shëndetin tonë, shpërndanim fletëpalosjet e para me udhëzime si të bëhen vetëkontrollat dhe kontrollat mjekësore, dhe merrnim nënshkrime peticioni me tre kërkesa për t’ua drejtuar përgjegjësve shëndetësore.

Kërkesat - TRI, që as sot pas 15 vitesh nuk do të ishin me të qëlluara:

1. Hartimi i strategjisë kombëtare për luftimin e kancerit të gjirit,
2. Përfundimi dhe funksionalizimi i Institutit Onkologjik
3. Sigurimi i një Autoambulance mobile me mamografi e ultrazë.

Informata në çdo shtëpi

Fitimi i grantit të parë nga Ambasada Amerikane, mundësoi funksionalizimin e Qendrës si dhe mbajtjen e 20 punëtorëve nëpër komuna, hartimin e fletëpalosjeve dhe dy broshurave 40 faqëshe, me udhëzime të ekspertëve mjekësore për mënyrën e diagnostikimit dhe trajtimit të kancerit të gjirit, në gjuhën shqipe e serbe.

Sapo përfundoi projekti i parë, patëm fatin që në Ambasadën Amerikane, në vitin 2007 erdhi me shërbim znj. Karyn Posner-Mullen, një entuziaste me përvojë në këtë fushë, e cila na ofroi grantin e dytë dhe më të cilën realizuam të gjitha aktivitetet e rëndësishme. Ajo themeloi Iniciativën Ballkanike për Kancer të Gjirit, BCCI, solli në Kosovë personalitete të rëndësishme, siç ishte Dr.Balash Bodai, ndihmoi Konferencën e parë për Kancer të gjirit në Telemjekësi, mbajtjen e Konferencës Ndërkombëtare të Onkologëve - ku u lansua pulla postare me simboliken e kancerit të gjirit, me qëllim të krijimit të një Fondacioni.

Në muajin **Tetor**, muajin ndërkombëtar të Luftimit të Kancerit të Gjirit, për herë të parë u mbajt manifestimi informativ-kulturor dhe ecja me moto Zbulimi i hershëm - mbijetesë, manifestim ky që QKLGJ JETA/VITA e ka bërë tradicional dhe e organizon çdo vit në Prishtinë dhe komuna të tjera.

Pra, e nisëm me qëllimin më të mirë dhe, përkundër sfidave të shumta, e bëmë realitet synimin që informata dhe ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit të arrijë në çdo shtëpi, tek mijëra gra përmes fjalës së gjallë, me informata të ekspertëve mjekësorë, me fletëpalosje, broshura, më me shumë se 80 punëtorë, në të gjitha komunat e Kosovës. Qëllimi është që sëmundja të zbulohet sa me herët, në fazat e para, kur mbijetesa është me e gjatë e më cilësore, kur trajtimet janë me të lehta e më të pakta, e kur shpenzimet janë me të vogla, si për familje ashtu edhe për shoqërinë.

Dhe, për gjithë këto 15 vite nuk është ndalur përpjekja e QKLGJ JETA/VITA, duke prezantuar e lobuar në institucionet relevante, të çdo Kryeministër, Ministër i shëndetësisë, deputet, për gjendjen e vështirë të pacienteve që atakohen me këtë sëmundje dhe duke bërë përpjekje të singërta, në ndihmën e grave, atyre që sapo janë përballur me sëmundjen, por edhe një numri të madh që mbijetojnë për vite, se sukcesi mund të arrihet vetëm me kujdes të shtuar të institucioneve përgjegjëse, me më shumë shërbime shëndetësore, profesionistë, pajisje dhe barna. Në vazhdimësi kemi kërkuar partneritet më të fuqishëm midis të sëmurve dhe mjekëve, midis popullatës e politikës, midis mediave e opinionit – për sensibilizim, humanizim dhe fuqizim të shoqërisë kosovare, për një mision të përbashkët, mision të mundshëm – të luftimit të kancerit të gjirit.

Tri vitet e kaluara, para pandemisë, kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me Shoqatën e Onkologëve të Kosovës, me të cilët gjatë muajit **Tetor**, Muajit Ndërkombëtar i Kancerit të Gjirit, organizuam punëtorë në 26 qendra komunale të Kosovës, ku qindra pjesëmarrës, gra e burra, morën informata si mund të zbulohet e trajtohet kanceri i gjirit, si të fitohet beteja me këtë sëmundje, sepse kjo nuk është luftë vetëm e grave por e tërë familjes e shoqërisë.

Korrespondenca:

revistamjeku@omk-rks.org

Klinika onkologjike-adresë e trajtimit dhe mirëkuptimit

Në vitin 2010 filloi punën Instituti Onkologjik, adresë ku pacientet tonë gjejnë mirëkuptimin më të madh dhe kanë vetëm fjalë miradije për mjeket – onkologë e radiologë, si dhe stafin e mesëm, të gjithë të përkushtuar, që bëjnë përpjekje për t'i shëruar, dhe për t'ua bërë më të lehta trajtimet e vështira pacienteve me kancer të gjirit. Por, ngarkesat e mëdha dhe të përditshme me numër të madh të pacienteve në hapësira të kufizuara dhe staf të pamjaftueshëm, mungesa e aparaturës e në veçanti e barnave, janë pengesa serioze për trajtimin me dinjitet të pacienteve të Klinikës së Onkologjisë.

Nga QKLGJ JETA/VITA në vazhdimësi bëhen kërkesa në drejtim të përgjegjësve të politikave shëndetësore që nëpër QMF të komunave të sigurohet staf profesional për të bërë diagnostikim më të hershëm me ultrazë dhe mamograf, të krijohen kushte që të mos ketë pritje të gjata për intervenim kirurgjik si dhe për trajtime onkologjike, të krijohen kushte që pacientët me kancer të gjirit të kenë mbështetje shumë të nevojshme psikosociale dhe fizioterapeutike në Institucionet ku trajtohen.

Përveq esencialeve, kërkohet që të kenë qasje edhe në pajisjet ndihmëse që pas trajtimit të mos ndjehen keq pa flokë, dhe pa proteza e gjoksore, gjë që rëndon shumë gjendjen psikike të tyre. Shpenzimet për këto nevoja nuk janë aq të mëdha dhe do të mund të siguroheshin nga Institucionet përgjegjëse, siç ndodh edhe në të gjitha vendet e regionit, në mënyrë që të mos presim vetëm lëmoshat e personave dhe shoqatave vullnetmira.

Edhe për të themeluar e zhvilluar aktivitete në një Qendër si kjo jona nuk është aq e lehtë. Gjatë tërë këtyre viteve kam njohur shumë gra të sëmurura, në spitale, ordianca, punëtori, e takime të çdo ditshme, sepse, duke mos ditur çka të bëjnë, ato paraqiten në telefonin tonë. Janë të pafund rrëfimet, është një dhembje njerëzore që përjetohet në mënyra të ndryshme. Më së shumti më kanë goditur vajzat e reja, në pritje të themelimit të familjeve të tyre, nënat e reja me fëmijë të vegjël, me brengen e madhe për ta, për rritjen e të ardhmen e tyre, gratë në moshë, të pafuqishme e barrë e fëmijëve e familjeve të tyre. Pastaj, çdo njëra veç e veç... Disa prej tyre nuk janë më por, janë në telefonin tim dhe më përkujtojnë vazhdimisht fytyrat e fatet e tyre. Nuk është e lehtë!

Mamografia mobile - Konsultat që shpëtuan shumë jetë

Në **tetor** të vitit 2014, pas një përpjekje të jashtëzakonshme, u realizua projekti kyq, i planifikuar në start të punës së QKLGJ JETA/VITA. Falë angazhimit të Grupit të Grave Parlamentare, u sigurua Autoambulanca

mobile me mamograf, që gjatë kësaj kohe, përkundër pengesave teknike, ka arrit të vizitohet të gjitha komunat e Kosovës dhe të bëjë kontrollin mamografik, depistimin e mijëra grave, aq sa nuk janë bërë më të gjithë aparaturat mamografike statike të Qendrave të Mjekësisë Familjare nëpër komuna. Gjatë kësaj periudhe, fal veprimtarisë të pandalur të shoqërisë civile në radhë të parë, që informata dhe ndërgjegjësimi për sëmundjen e kancerit të gjirit të arrijë në çdo mjedis si dhe punës të palodhshme të stafit të Repartit të Radiologjisë, interesimi i grave ishte i jashtëzakonshëm, dhe si rezultat u zbulua një numër i konsiderueshëm i grave me probleme të gjirit.

Nga tri kërkesat që i parashtrua me rastin e themelimit të Qendrës, edhe sot mbeti i porealizuar hartimi i strategjisë kombëtare për luftimin e kancerit të gjirit, por një strategji e tillë nuk ekziston as për luftimin e sëmundjes së kancerit në përgjithësi në Kosovë.

Pas përcjelljes 17 vjeçare të kësaj problematike, nuk mund të mos e theksoj bindjen time të thellë, se në asnjë fushë nuk janë bere lojëra aq të shumta të politikëbërësve, siç ka ndodhur me Ministrinë e Shëndetësisë, ku për vite me radhe janë zgjedhur udhëheqës jokompetente që me veprimet e tyre jo vetëm që e kanë dëmtuar politikën shëndetësore të Kosovës, nga e cila në masë shumë të madhe ka pësuar popullata, por gati të gjithëve iu është ndërprerë mandati dhe janë përballur me gjykata për shkak të keqpërdorimeve edhe me atë buxhet të kufizuar, i cili është ndarë për nevojat e qytetarëve. Për organizim të punëve e për thithje të donacioneve as që bëhet fjalë.

Këto dështime të politikave shëndetësore kanë bërë që në Kosovë të mos ketë një Qendër të Shërbimit Paliativ, hallka me e ndjeshme e problemeve me të cilat ballafaqohet popullata e sëmurë nga kanceri. Vetë sëmundja është e rëndë, zakonisht diagnostikohet në stadi më të vonshme, kur trajtimi është i gjatë dhe i mundimshëm - intervenim kirurgjik, kimioterapi, radioterapi, terapi hormonale etj. që flasin për rraskapitjen e pacientes dhe familjes së saj e cila është e detyruar ta përcjellë e mbështesë në çdo hap. Por në fazat terminale të sëmundjes, në mungese të një Qendre për trajtim paliativ, traumat nëpër të cilat kalojnë këta të sëmurë bashkë me familjarët e tyre janë shumë të rënda dhe jodinjitoze.

Njerëzit e vullnetit të mirë

E vetëdijshme për natyrën shkencore e profesionale të Revistës MJEKU, kërkoj mirëkuptim që të shpreh mirënjohjen time të madhe për të gjithë njerëzit vullnetmire të cilët na kanë ndihmuar në realizimin e misionit tonë, për vite me radhë.

Së pari falenderoj, mediat elektronike dhe të shkruara, të cilat kanë përcjellë mesazhin

informativ e ndërgjegjësuës në çdo cep të Kosovës.

Falenderoj komunitetin artistik, në krye me regjisoren Burbuqe Berisha, e cila çdo **Tetor**, Muaj Ndërkombëtar të Luftimit të Kancerit të Gjirit, përgatitë video promovuese me mesazhe vetëdijësuese, ku marrin pjesë aktorët, këngëtarët dhe sportistët tanë më të shquar, të shfaqen falas në të gjitha radiotelevizionet e Kosovës, ditë me radhë në terminet më të përcjellura.

Në fund dëshiroj t'i falënderohem individëve dhe kompanive të cilët kanë ndihmuar shoqatën dhe me kontributin e tyre kanë vërtetuar se **ÇDO HERË MUND TË BËHET PUNË, KUR EKZISTON VULLNETI !!!**

AKSIONI I AMC PËR PARANDALIMIN E KANCERIT TË QAFËS SË MITRËS



Edea Blyta

Doktor i Mjekësisë

Që nga viti 2009 OJQ “Aksioni për nëna dhe fëmijë” (AMC) ka për qëllim uljen e shkallës së vdekshmërisë së foshnjave dhe mirëqenien e nënave dhe fëmijëve në vendin tonë.

